



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2789/2 prot.,

Datë 13.11.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ANULIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT
SI DHE ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR VENDIMIN
E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-78172-08-23-2023, me objekt “*Drurë shkurre Dekorative*”, me fond limit 66,666,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Agro - Korani” SHPK në procedurën e e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

“Agro - Korani” SHPK me NIPT L13329801V dhe adresë: Ura e Draxhit, Kavajë

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit me adresë: Rruga “Xhezmi Delli”, Godina 20, Tiranë

Në datën 10.11.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3591, si dhe nr. protokolli 2789/2023 datë 13.11.2023 e operatorit ekonomik “Agro - Korani” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-78172-08-23-2023, me objekt “*Drurë shkurre Dekorative*”, me fond limit 66,666,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, si dhe kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së tij ekonomike.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Agro - Korani” SHPK kundërshton me anë të ankimit elektronik me nr. A/2023/3591, si dhe nr. protokolli 2789/2023 datë 13.11.2023.

1. OE “AGRO-KORANI” sh.p.k. nuk plotëson kriterin e kualifikimit të kërkuar në DST pika 2.3.2, gërma “a”, pasi me dokumentacionin e paraqitur nuk provon se disponon kërkesat e VKM nr. 742, datë 06.11.2003, lidhur me fuqinë punëtore.

2. OE “AGRO-KORANI” sh.p.k., në Shtojcën nr. 8 Formulari Përmbledhësi Vetëdeklarimit ka deklaruar se për realizimin e kësaj kontrate prokurimi, do të mbështetet në kapacitetet e shoqërisë “KURORA” sh.p.k. Nga verifikimi I dokumentacionit të paraqitur nga OE “KURORA” sh.p.k. rezulton se nuk provon se disponon kërkesat e VKM nr. 742, datë 06.11.2003, lidhur me fuqinë punëtore.

3. OE “AGRO-KORANI” sh.p.k., në Shtojcën nr. 8 Formulari Përmbledhës I Vetëdeklarimit ka deklaruar se për realizimin e kësaj kontrate prokurimi, do të mbështetet në kapacitetet e shoqërisë “KURORA” sh.p.k. Nga verifikimi I dokumentacionit të paraqitur nga OE “KURORA” sh.p.k. rezulton se nuk plotëson kriterin e kualifikimit të kërkuar në DST pika 2.3.2, gërma “b” listëpagesa e çdo muaji të Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi (Formulari numër E-SIG 025/a.1) për periudhën e tre muajve të fundit (mungojnë listëpagesat e muajve maj, qershor dhe korrik 2023). Gjithashtu edhe në Formularin e Vetëdeklarimit shtojca 8 nuk ka deklaruar se disponon listëpagesat e tremuajve të fundit (maj, qershor dhe korrik 2023).

4. OE “AGRO-KORANI” sh.p.k., nuk plotëson kriterin e kualifikimit të kërkuar në DST pika 2.3.3, lidhur me paraqitjen e një Deklarate nga Administratori I shoqërisë për përcaktimin e drejtuesit teknik (Inxhinier pyjesh) I cili do të ndjekë zbatimin e projektit.

5. OE “AGRO-KORANI” sh.p.k., nuk plotëson kriterin e kualifikimit të kërkuar në DST pika 2.3.4. Çertifikatat e paraqitura nga OE “AGRO-KORANI” sh.p.k., të lëshuara nga Enti Shtetërori Farnave dhe Fidanëve datë 12.09.2023 nuk kanë të përfshira të gjithë bimësinë që kërkohet në preventivnga AK, në kundërshtim me kriterin e kërkuar. 6. OE “AGRO-KORANI” sh.p.k., ka paraqitur një kontratë furnizimi me një subjekt të huaj “Vanuçi Piante” srl, por nuk ka paraqitur certifikatat e origjines dhe fitosanitare të këtij n subjekti sipas kërkesave të veçanta të kualifikimit.

7. OE “AGRO-KORANI” sh.p.k., ka paraqitur disa çertifikata fitosanitare të huaja të cilat nuk janë të pajisura me vulë Apostille, sipas kërkesave të Konventës së Hagës datë 05.10.1961, në kundërshtim me kërkesat e veçanta të kualifikimit

Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij pretendon:

“[...]

Sikurse edhe cituam më sipër, autoriteti kontraktor, në datën 01.11.2023 nëpërmjet SPE ka publikuar njoftimin për Anullimin e procedurës së prokurimit public me arsyetimin: ç) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objective, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar.

Ky është një veprim të cilin ne e konsiderojmë të padrejtë dhe në kundërshtim, me ligjin, pasi nuk ka asnjë shkak apo rrethanë të paparashikuar ose autoritetit kontraktor nuk mund ti ndryshojë aftësia paguese në afatin kur duhet të benë të shpallje fituesi. Verifikimi e aftësisë paguese autoriteti kontraktor mund të bënte që në shpallje të kësaj procedure, e më pas në momentin e publikimit të kuotimit dhe vlerësimit, dhe jo 20 ditë më pas.

Autoriteti kontraktor, nuk e ka shoqëruar vendimin e anullimit me asnjë shpjegim të detajuar se cila është shkak apo rrethana e jashtëzakonshme. Nuk ka paraqitur asnjë document apo fakt që e dëshmon ndryshimin e aftësisë paguese të autoritetit kontraktor. Të gjitha sa më sipër cituam, na bën të kuptojmë që ky është një veprim i qëllimshëm dhe i pambështetur në ligj dhe kundër frymës dhe qëllimit të Ligjit të Prokurimit Publik.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 13.11.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro